

Raporti (janar - qershor)



*Fushë Kosovë
Gusht 2020*

Përmbajtja

1	Hyrje	Aktivitetet kryesore të INFRAKOS-it	2
2	Struktura organizative	Struktura organizative e INFRAKOS-it	8
3	Performanca afariste	Departamenti i komunikacionit	10
		Departamenti i MLH	13
		Departamenti i veprimtarisë elektroteknike	18
		Zyra e planifikimit dhe zhvillimit	19
		Departamenti për pronë dhe standarde	21
		Departamenti i administratës	22
		Departamenti i MPM, SHMP dhe IT	24
		Departamenti i prokurimit	26
		Kontrolli i brendshëm	27
4	Performanca financiare	Performanca financiare e INFRAKOS-it	28
		Të hyrat	29
		Shpenzimet	30
		Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve	31
5	Procedurat gjyqësore	Procedurat gjyqësore të realizuara në gjashtëmujorin e parë	32
		Procedurat gjyqësore që pritet të realizohen	33
6	Transaksionet	Transaksionet në gjashtëmujorin e parë	34
7	E ardhmja	Sugjerimet për ngritjen e performancës	35

1. Aktivitetet kryesore të Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës SHA-INFRAKOS

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS në gjashtëmujorin e parë të këtij viti ka qenë e angazhuar maksimalisht për realizimin e detyrave të përcaktuara me planin e biznesit, respektivisht me planin e veprimit të kompanisë. Përkundër angazhimeve tona dhe rezultateve solide sa i përket mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore, për fat të keq edhe ky gjashtëmujor karakterizohet me gjendjen tejet të vështirë financiare nëpër të cilën po kalon INFRAKOS-i, andaj edhe sfidat e tejkallimit të kësaj gjendjeje janë shumë të mëdha. INFRAKOS-si si çdoherë ka bërë të pamundurën që përkundër vështirësive financiare të ruaj dhe të mbajë në nivelin e duhur infrastrukturën hekurudhore duke mundësuar kështu qarkullimin e sigurt të trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave.

Prandaj, falë angazhimit të stafit të mirëmbajtjes dhe intervenimeve të tyre në evitimin e pengesave dhe mangësive eventuale, e tërë infrastruktura hekurudhore duke filluar nga shtresa e poshtme dhe e lartë e binarëve, urat, lëshesat, tunelet, pajisjet sinjalo siguroese, telekomunikuese dhe ato të energjetikës, kanë qenë në nivelin e duhur dhe funksionimi i tyre ka qenë i përhershëm. Me një fjalë, pa marrë parasysh kohën dhe kushtet atmosferike, infrastruktura hekurudhore ka qenë e mirëmbajtur dhe ka ofruar shërbime të kënaqshme për operatorët e transportit hekurudhor.

Gjashtëmujori i parë i vitit 2020 ka qenë i ndërlidhur me një numër të konsideruar të aktiviteteve të INFRAKOS-it të cilat ndërlidhen edhe me strukturën mbikëqyrëse dhe atë menaxhuese të kompanisë. Meqenëse me vendimin e Qeverisë nr.04/04 të datës 28.02.2020 është shkarkuar Bordi i Drejtorëve të INFRAKOS-it, Bordi i ri i Drejtorëve është themeluar me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 04/21 të datës 02.04.2020.

Menjëherë pas themelimit, Bordi i Drejtorëve në takimin e jashtëzakonshëm të datës 07.04.2020, pas analizave, diskutimeve dhe shqyrtimit të dokumenteve të INFRAKOS-it, me vendimin nr. 2/14 të datës 08.04.2020 ka bërë largimin e përkohshëm nga puna të Kryeshefit Ekzekutiv.

Në të njëjtën ditë Bordi i Drejtorëve me vendimin nr. 2/15 të datës 08.04.2020 ka bërë emërimin e UD të Kryeshefit Ekzekutiv. Në këtë takim të Bordit të Drejtorëve ku janë diskutuar shumë çështje, ndër të tjera pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë me vendimin nr. 2/18 të datës 24.04.2020 është vendosur që Kryeshefit të suspenduar t'i ndërpritet marrëdhënia e punës.

Ky gjashtëmujor karakterizohet edhe me një problem të paparë deri më tani e që ndërlidhet me përhapjen e pandemisë me COVID 19 duke filluar nga muaji mars. Siç dihet pandemia përveç problemeve shëndetësore ka shkaktuar edhe probleme tejet të mëdha ekonomike dhe është normale që këto probleme ekonomike ndërlidhen edhe me INFRAKOS-in.

Prandaj, gjatë këtij gjashtëmujori, përveç angazhimeve ditore në mirëmbajtjen dhe eksploatimin e infrastrukturës hekurudhore, INFRAKOS-i ka pasur edhe angazhime tjera shumë të rëndësishme të cilat janë listuar në vijim:

- Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore në nivelin e duhur të sigurisë për qarkullimin e trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave;
- Vazhdimësia e punëve në projektin e rehabilitimit dhe modernizimit të Linjës së 10-të hekurudhore (Leshak - Fushë Kosovë – Hani i Elezit) dhe projektet tjera zhvillimore;
- Përgatitja dhe dorëzimi me kohë i të gjitha informatave dhe raporteve të ndryshme për aksionarin dhe palët tjera të interesit
- Ruajtja dhe zhvillimi i raporteve të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- Ruajtja e stabilitetit financiar dhe likuiditetit të kompanisë;

1.1 Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore

Gjashtëmujori i parë i vitit 2020 konsiderohet si periudhë në të cilën prioriteti numër një i kompanisë ka qenë i orientuar në drejtim të mirëmbajtjes së rregullt dhe investive të infrastrukturës hekurudhore, në mënyrë që kjo infrastrukturë të garantojë siguri maksimale për qarkullimin e të gjitha mjeteve lëvizëse të transportit të udhëtarëve dhe mallrave.

Gjatë këtij gjashtëmujori të gjithë sektorët e INFRAKOS-it kanë pasur një angazhim të veçantë në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, sidomos në kohën me temperatura të ulëta gjatë dimrit dhe temperaturave të larta gjatë muajit qershor, ashtu që komunikacioni hekurudhor të zhvillohet pa problem. Angazhimi i të gjithë punonjësve për realizimin e detyrave të parashtruara ka qenë shumë i madh, andaj gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur asnjë ndërprerje apo problem tjetër në qarkullimin e trenave për shkak të infrastrukturës. Për më tepër, të gjitha kërkesat e operatorit të transportit (TRAINKOS) dhe atij privat RAILTRANS për trena të jashtëzakonshëm të udhëtarëve dhe të mallrave janë realizuar menjëherë.

1.2 Projektet Zhvillimore të INFRAKOS-it

1.2.1 Linja e 10 (dhjetë) hekurudhore

Tanimë është e ditur se njëri ndër projektet kryesore të INFRAKOS-it padyshim është Rehabilitimi Gjeneral i Linjës së 10 Hekurudhore e cila linjë paraqet njërën ndër linjat kryesore e cila e lidhë Kosovën me Serbinë dhe Maqedoninë. Për fat të keq ky projekt ka pasur vonesa të mëdha, kështu që prioriteti i Bordit të ri të Drejtorëve dhe UD të Kryeshefit Ekzekutiv ka qenë i orientuar në ndryshimin total të qasjes ndaj këtij projekti, duke kërkuar nga të gjitha palët (kontraktori, kompania mbikëqyrëse dhe Njësia mbi Zbatimin e Projekteve) përshejtimin e realizimit të këtij projekti. Pas analizave të bëra Bordi i Drejtorëve ka kërkuar nga

Ministritë përkatëse që të bëhet auditimi i këtij projekti nga një kompani ndërkombëtare e licencuara për këtë fushë. Mirëpo, pa marrë parasysh këtë, gjatë kësaj kohe ka pasur me dhjetëra e dhjetëra takime, video konferenca dhe shkresa drejtuar të gjitha palëve të kyçura në këtë projekt për përshejtimin e punëve, gjë që më në fund kontraktori ka bërë hapjen e disa fronteve të punës dhe tani pritet edhe dorëzimi i programit të punëve i përditësuar për përfundimin e këtij projekti.

Ndër të tjera, gjatë këtij gjashtëmujori kanë ndodhur zhvillime shumë të rëndësishme të cilat shkurtimisht janë prezantuar në vijim:

- Janë mbajtur shumë takime me të gjitha palët e interesit për projektin e rehabilitimit të fazës së parë pasi që është konsideruar se ka ngecje në realizimin e punëve;
- Është bërë përshejtimi i punëve nga kompania punëkryese në rehabilitimin gjeneral të fazës së parë (Fushë Kosovë – Hani i Elezit);
- Gjatë këtij gjashtëmujori po ashtu ka filluar të bëhet vlerësimi i ofertave për përzgjedhjen e kompanisë e cila duhet të bënë rehabilitimin e fazës së dytë të Linjës së 10 (dhjetë) Hekurudhore (Fushë Kosovë – Mitrovicë);
- Ka përfunduar projekt dizajni për sinjalizim dhe telekom për rehabilitimin e pajisjeve sinjalo siguruese për fazë (1+2) të linjës së 10 hekurudhore;

1.2.2 Linja hekurudhore e aeroportit

Njëri ndër projektet e infrastrukturës hekurudhore i cili po ashtu financohet nga grantet e Kornizës Investive të Ballkanit Perëndimor (WBIF) është edhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e linjës hekurudhore (Prishtinë – Fushë Kosovë – Aeroporti i Prishtinës), projekt ky i cili është i një rëndësie të veçantë për lidhjen e aeroportit me hekurudhë.

Ky projekt është në zbatim që nga takimi fillestar i datës 10.07.2019. Ekipi ka paraqitur një seri të rezultateve: Draftin e Dizajnit Preliminar (përfshirë alternativat për skemat trasesë dhe vend-ndaljet, propozimin për vend-ndaljet e reja dhe dizajnin e platformave). Raportin e Inspektimit të Urave, Raportin e Shqyrtimit Mjedisor dhe Social, Raportin e Hidrologjisë dhe Drenazhimit, Dizajnin e Elektrifikimit, Raportin e Shqyrtimeve Gjeodezike, Raportet Gjeo-teknike / Gjeologjike / dhe të shqyrtimit të Strukturave).

1.2.3 Projekti i Dizajnit Preliminar për Linjën e 7 (shtatë) hekurudhore

Përveç linjës së 10 hekurudhore, INFRAKOS-i është i interesuar edhe për rehabilitimin e linjave tjera hekurudhore, ashtu që të kemi një rrjet hekurudhor i cili do t'i plotëson standardet e BE-së. Në këtë drejtim është arritur që të përfitojmë 1.25 milion euro grante të WBIF-it me të cilat kemi filluar të bëjmë hartimin e projekt dizajnit preliminar për rehabilitimin gjeneral dhe modernizimin e

linjën së 7-të hekurudhore (Kufiri me Serbinë – Podujevë – Prishtinë - Fushë Kosovë).

Ky projekt dizajn është në përfundim e sipër, ndërsa afati i përfundimit varet nga situata në teren për shkak të pandemisë me COVID 19. Pas përfundimit të këtij projekt dizajni preliminar do të krijohen kushtet për bisedime me institucionet financiare ndërkombëtare për gjetjen e mundësive të financimit për realizimin e rehabilitimit gjeneral edhe të kësaj linje hekurudhore e cila është me rëndësi të madhe për lidhjen e Kosovës me vendet e rajonit dhe më gjerë.

Ngjashëm me Linjën e 10-të Hekurudhore mundësia e investimeve dhe granteve të BE-së edhe për Linjën e 7-të hekurudhore është e madhe pasi që e njëjta i përket zgjerimit të rrjetit gjithëpërfshirës të Rrjetit Trans Evropian të Transportit (TEN-T). Prandaj kjo paraqet një shans shumë të mirë për tërheqjen e investimeve dhe granteve të BE-së.

Deri më tani, ekipi i ekspertëve ka paraqitur analizën e opsioneve teknike (përfshirë raportin teknik dhe vlerësimet e kostos, planin e përgjithshëm, planet horizontale / gjatësore për secilin opsion, performancën operative dhe vlerësimin e kapacitetit të linjës paraprake) dhe metodologjinë e MCA-së (analizat e kriterëve të shumëfishta).

Ekipi është në kontakt me INFRAKOS për të pritur reagime për çështje specifike (opsione teknike, identifikimin e kontakteve për organizimin e panelit për MCA (Multi Criteria Analysis), dokumente dhe të dhëna si: anekset e Master Planit të Aeroportit, të dhënat për kalimet kufitare, raportet e përkohshme të Planit të Qëndrueshëm të Mobilitetit të Prishtinës, etj.).

1.3 Përgatitja dhe dorëzimi me kohë i të gjitha informatave dhe raporteve të ndryshme për aksionarin dhe palët tjera të interesit

Njëri ndër obligimet e shumta të INFRAKOS-it është i ndërlidhur me raportimin e rregullt për bordin e drejtorëve dhe institucionet përkatëse shtetërore lidhur me gjendjen e kompanisë dhe zhvillimet e ndodhura për periudha të caktuara. Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti INFRAKOS-i ka hartuar dhe dorëzuar me kohë të gjitha informatat e kërkuara nga institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare të cilat lidhen me sistemin hekurudhor.

1.4 Hartimi i Ekspozeut të Rrjetit për vitin 2021

Përveç detyrave të përditshme në mirëmbajtje dhe organizim të transportit hekurudhor, gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti është bërë edhe hartimi i njërit nga dokumentet më të rëndësishme të kompanisë: Ekspozeu i Rrjetit për vitin 2021. Ky Ekspoze është përpiluar në bazë të kreut IV të Ligjit mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-063, respektivisht nenit 55, 61, 62, 64 dhe 65 të këtij ligji, si dhe Udhëzimeve Administrative të Ministrisë së Infrastrukturës nr. 1991/13 dhe atë me nr. 1992/13 të datës 28.06.2013.

Vlen të përmendet se INFRAKOS-i ua ka dërguar Ekspozeun e Rrjetit 2021 të gjitha palëve të interesit dhe bazuar në nenin 58 të Ligjit mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-063, ka përfunduar procesin e konsultimit me të gjitha palët e interesit të parapara me këtë ligj. Pasiqë ka përfunduar procesi i konsultimit pritet që Ministria e Infrastrukturës të bënë aprovimin e Ekspozeut të Rrjetit për vitin 2021 i cili Ekspoze është hartuar konform propozimeve të bëra nga ekspertët e jashtëm gjatë realizimit të projektit mbi Pagesat e Qasjes në Binarë dhe Planin e Menaxhimit të Aseteve, projekt ky i realizuar gjatë vitit 2019.

1.5 Hartimi i Ekspozeut të Rrjetit të Terminalit të Mallrave për vitin 2021

Në kuadër të projektit të traktatit të transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor, njëra nga detyrat ka qenë që të bëhet edhe hartimi i Ekspozeut të Rrjetit mbi Terminalet e Mallrave, andaj INFRAKOS-i ka hartuar me kohë dhe e ka publikuar Ekspozeun e Rrjetit për Terminalin e Mallrave në Miradi për vitin 2021, duke e bërë kështu edhe publikimin e këtij ekspozeu në të tria gjuhët në ueb faqen e kompanisë.

1.6 Përgatitja e raporteve dhe dokumenteve tjera të INFRAKOS

Gjashtëmujori i parë i këtij viti ndër të tjera ka qenë i përmbushur edhe me përgatitjen e dokumenteve të parapara me ligj dhe dorëzimin e tyre në institucionet përkatëse. Këtu do të përmendim punën e madhe dhe tepër të suksesshme e cila është bërë për:

- Hartimin, aprovimin nga bordi dhe dorëzimin e raportit vjetor 2019;
- Hartimin, aprovimin nga bordi dhe dorëzimin e raportit tremujor për kuartalin e parë të vitit 2020;
- Hartimin dhe miratimin e raporteve mujore për muajin Janar, Shkurt, Prill dhe Maj të vitit 2020;
- Auditimin e pasqyrave financiare nga auditori i jashtëm për vitin 2019;
- Hartimin dhe dorëzimin e raportit të kënaqshmërisë së klientëve për vitin 2019;
- Hartimin e raportit vjetor të sigurisë për vitin 2019;
- Hartimin dhe dorëzimin e Ekspozeut të Rrjetit për vitin 2021 tek të gjitha palët e interesit; dhe
- Hartimin dhe publikimin e Ekspozeut të Rrjetit për terminalin e mallrave në Miradi për vitin 2021
- Hartimin e raportit të vlerësimit të performancës së menaxhmentit për vitin 2019.

1.7 Bashkëpunimi i INFRAKOS-it me palët e interesit

Gjashtëmujori i parë i këtij viti ka pasur edhe shumë zhvillime tjera sa i përket bashkëpunimit të kompanisë tonë me institucionet të cilat drejtpërsëdrejti apo

tërthorazi janë përgjegjëse për sektorin hekurudhor. Kështuqë falë një angazhimi dhe korrektësie të madhe është realizuar me sukses të plotë përgatitja e të gjitha dokumenteve dhe raporteve për Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit (si pronare e INFRAKOS-it), për Ministrinë e Infrastrukturës (si ministri politikbërëse), për Ministrinë e Integritimit Evropian (si ministri e integritimit edhe të sektorit hekurudhor me BE-në), dhe me Ministrinë e Financave (si ministri përgjegjëse për buxhetin e shtetit dhe financimin e projekteve kapitale të hekurudhës).

Një punë shumë e suksesshme në kuadër të bashkëpunimit gjatë pjesës së parë të këtij viti është bërë edhe me institucionet e huaja duke plotësuar pyetësorë të ndryshëm, përgatitur dhe prezantuar informata të shumta në interes të zhvillimit të sektorit hekurudhor. Fjala këtu është për Institucionet e Komisionit Evropian, Traktatin e Transportit për vendet e Ballkanit Perëndimor (TREATY); Mekanizmin e Procesit të Dialogut për Stabilizim Asocim (SAPD), Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF), Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Bankën Evropiane të Investimeve (EIB), e të tjera.

1.8 Stabiliteti financiar i kompanisë

Si zakonisht edhe këtë gjashtëmuor përveç prioritetit numër një që lidhet me sigurinë e komunikacionit hekurudhor, si prioritet i rëndësishëm së veçantë ka qenë dhe mbetet gjendja financiare e INFRAKOS-it dhe kërkesa e jonë permanente për gjetjen e një zgjidhjeje afatgjate për këtë çështje jetike.


Për fat të keq vazhdimi i situatës tepër të rëndë financiare i vitit 2019 ka vazhduar edhe në këtë periudhë kohore, ku pa fajin tonë dhe për shkak të mosgatishmërisë së institucioneve vendimmarrëse për subvencionimin e kompanisë, ne kemi arritur në një situatë tejet dramatike. Në qoftë se autoritetet përgjegjëse nuk ndërmarin hapat e duhur dhe të kërkuar dhjetëra e dhjetëra herë nga INFRAKOS-i, atëherë kjo kompani në mungesë të mjeteve financiare do të detyrohet të ndërpresë funksionimin. Kjo nuk guxon dhe nuk do të duhej të ndodhë, andaj ne presim që institucionet tona të realizojnë kërkesën ligjore për mbështetjen financiare të INFRAKOS-it, sepse sistemi hekurudhor është në të mirën e vendit tonë.

Tanimë është absurde të vazhdohet edhe më tutje me reduktimin e shpenzimeve, sepse kemi arritur në një shkallë ku do të cenohet siguria e qarkullimit të trenave, prandaj ne nuk guxojmë dhe assesi nuk do ta lejojmë që të ndodhë një gjë të tillë.

Vlen të theksohet se angazhimi i Bordit të Drejtorëve dhe menaxhmentit të kompanisë nga muaji prill e tutje ka qenë shumë i madh për inkasimin e borxheve si dhe për rritjen e efikasitetit në shfrytëzimin e peronës. Kjo ka dhënë rezultate të mira por nuk garanton siguri financiare pa u bërë subvencionimi i kërkuar i kompanisë nga shteti.

2. Struktura organizative e kompanisë

Në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti struktura organizative e kompanisë nuk ka psuar ndryshime në krahasim me strukturën paraprake të vitit 2019. Në kontekst të pasqyrimin të strukturës ekzistuese të kompanisë, në vijim është prezantuar organogrami aktual i INFRAKOS-it.



Në fillim të muajit janar 2020 INFRAKOS-i ka pasur 304 punonjës të rregullt, ndërsa në fund të muajit qershor 2020 në INFRAKOS numri i punëtorëve ka qenë 288 (përfshirë anëtarët e BD-së) dhe atë:

- Punonjës të rregullt janë 288 të punësuar, prej të cilëve 225 ose 78,12 % kanë kontrata pune në afat të pa caktuar, 44 ose 14,93% kanë kontrata pune në afat të caktuar, 16 ose 5,55% kanë qenë të sistemuar me vendime të përkohshme dhe 4 ose 1,38% punëtorë kanë qenë të

- angazhuar në bazë të Marrëveshjes me Komunën e Ferizajt. Dhe AC BETON ;
- Meshkuj janë 270 të punësuar dhe përbëjnë 93,4% nga totali i të punësuarve;
 - Femra janë 19 të punësuar dhe përbëjnë 6,59% nga totali i të punësuarve;
 - Shqiptarë 282 të punësuar dhe përbëjnë 97,56% nga totali i të punësuarve;
 - Serb janë 6 të punësuar dhe përbëjnë 2,08% nga totali i të punësuarve;
 - Ashkalinjë dhe rom është vetëm 1 i punësuar dhe përbën 0,34% nga totali i të punësuarve
 - Me kualifikim superior janë 74 punonjës
 - Me kualifikim të lartë janë 5 punonjës
 - Me kualifikim të mesëm janë 174 punonjës; dhe
 - Me kualifikim fillor dhe kualifikim hekurudhor janë 36 punonjës.

3. Performanca afariste e kompanisë

Prioriteti kryesor i menaxhmentit të INFRAKOS-it në këtë gjashtëmujor si zakonisht ka qenë mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore ashtu që të zhvillohet pa problem transporti i udhëtarëve dhe ai i mallrave. Angazhimet e departamenteve ekzekutive kanë qenë në nivelin e duhur, duke i realizuar kështu detyrat e parapara që përkundër sfidave të mëdha të cilat ndërlidhen me dëmtimet e infrastrukturës, mungesës së pjesëve rezervë dhe problemeve tjera të natyrave të ndryshme, ne kemi arritur që këtë gjashtëmujor ta përfundojmë me sukses.

Pra falë angazhimeve kontinuale të këtyre departamenteve, mund të konstatojmë se INFRAKOS-i ka pasur një afarizëm të mirë gjatë periudhës kohore (janar – qershor) 2020. Kjo që themi bazohet në rrethanat ekzistuese dhe gjendjen financiare e cila pa fajin e INFRAKOS-it nuk është e mirë.

3.1 Departamenti i komunikacionit

Në gjashtëmujorin e parë të këtij vitit departamenti i komunikacionit i ka realizuar me sukses detyrat e parashtuara. Angazhimi i përhershëm dhe përballja me sfidat e shumta, sidomos në sezonin dimëror, por edhe në muajt tjerë, ka bërë që ky departament të realizojë me sukses të lartë organizimin e komunikacionit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave. Gjatë këtij gjashtëmujori është realizuar në tërësi orari i lëvizjes së trenave, dhe çka është më e rëndësishme, është realizuar me sukses edhe çdo kërkesë e Operatorit të Transportit Hekurudhor TRAINKOS dhe operatorit tjetër privat RAILTRANS për futjen në qarkullim të trenave të jashtëzakonshëm dhe atyre jashtë orarit të lëvizjes.

Ndër punët kryesore të realizuara në këtë departament gjatë këtij gjashtëmujori do të përmendim:

- Realizimin e suksesshëm të orarit të lëvizjes së trenave me kohë dhe pa problem;
- Realizimin pa problem të lëvizjes së trenave sipas kërkesave ad hok të TRAINKOS-it apo edhe të RAILTRANS-it;
- Realizimin e kontrollimeve nëpër stacionet hekurudhore në drejtim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve ndaj operatorëve të transportit dhe publikut;
- Realizimin e kontrollimeve të natës, në drejtim të mbarëvajtjes së punëve për qarkullimin e trenave;
- Realizimin e pastrimit të hapësirave të stacioneve hekurudhore;
- Realizimin e kontrollimit teknik të pajisjeve të infrastrukturës së bashku me sektorët tjerë të mirëmbajtjes;
- Realizimin e furnizimit të stacioneve hekurudhore me material sipas nevojës dhe kërkesave;

- Realizimin e shkollimit të stafit të cilët merren me organizimin dhe zhvillimin e komunikacionit;
- Realizimin e tërësishëm të shërbimeve të transportit në terminalin e mallrave;
- Realizimin e detyrave për llogaritjen e qasjes në binarë si dhe ofrimin e informatave për përgatitjen e faturave për pagesë;
- Realizimin edhe të punëve dhe detyrave tjera sipas kërkesave ditore.

Për shkak të pasqyrimit më të mirë, në tabelën vijuese është prezantuar lëvizja e trenave të udhëtarëve gjatë këtij gjashtëmujori:

Krahasimi i trenave	Trenat e udhëtarëve			
	Numri trenave	Trenat e rregullt	Trenat ad hok	Trenat e revokuar
Viti 2020	952	935	17	885
Viti 2019	1798	1788	10	22
Ndryshimi (2020- 2019)	-846	-853	7	863

Ndërsa në tabelën vijuese është prezantuar lëvizja e trenave të mallrave gjatë këtij gjashtëmujori:

Krahasimi i trenave	Trenat e mallrave			
	Numri trenave	Trenat e rregullt	Trenat ad hok	Trenat e revokuar
Viti 2020	935	279	656	333
Viti 2019	1025	519	506	383
Ndryshimi (2020- 2019)	-90	-240	150	-50

Në tabelën vijuese është bërë prezantimi i rasteve të jashtëzakonshme të cilat kanë ndodhur në këtë gjashtëmujor.

Rastet e jashtëzakonshme	Numri i aksidenteve	Aksidentet në vendkalime	Aksidentet në stacione dhe linjë të hapur	Vlera e dëmeve materiale	Auto të dëmtuara	Numri i personave të vdekur	Numri i personave të lënduar
Viti 2020	3	2	1	2,970.00	3	0	1
Viti 2019	8	5	3	0.00	5	2	6
Ndryshimi (2020 - 2019)	-5	-3	-2	2,970.00	-2	-2	-5

Departamenti i komunikacionit është departamenti i cili i siguron të hyrat kryesore të kompanisë, qoftë nga pagesat e qasjes në rrjetin hekurudhor, apo qoftë nga pagesat e ofrimit të shërbimeve në terminal.

Në tabelën vijuese është bërë prezantimi i të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjetin hekurudhor nga operatori i Transportit TRAINKOS për gjashtëmujorin e parë të këtij vitit duke i krahasuar ato me të hyrat e gjashtëmujorit të parë të vitit 2019.

Lloji i të hyrave	Të hyrat nga trenat e udhëtarëve	Të hyrat nga trenat e mallrave	Të hyrat nga trenat ad hok	Të hyrat nga shërbimet tjera	Të hyrat totale
Janar -Qershor 2020	65,856.49	66,446.36	0.00	38,196.11	170,498.96
Janar -Qershor 2019	127,560.57	62,781.54	0.00	45,741.06	236,083.17
Ndryshimi (2020 - 2019)	-61,704.08	3,664.82	0.00	-7,544.95	-65,584.21

Në tabelën vijuese është bërë prezantimi i të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjetin hekurudhor nga operatori i Transportit RAILTRANS për gjashtëmujorin e parë të këtij vitit duke i krahasuar ato me të hyrat e gjashtëmujorit të parë të vitit 2019.

Lloji i të hyrave	Të hyrat nga trenat e mallrave	Të hyrat nga trenat ad hok	Të hyrat nga shërbimet tjera	Të hyrat totale
Janar -Qershor 2020	6,600.10	0.00	4,050.40	10,650.50
Janar -Qershor 2019	8,601.41	0.00	5,425.76	14,027.17
Ndryshimi (2020 - 2019)	-2,001.31	0.00	-1,375.36	-3,376.67

Ndërsa në mënyrë të ngjashme është bërë edhe prezantimi i të hyrave nga terminali i mallrave për gjashtëmujorin e parë të këtij vitit duke i krahasuar ato me të hyrat e gjashtëmujorit të parë të vitit 2019.

Të hyrat nga Terminali	Numri i kontejnerëve	Të hyrat nga krani	Të hyrat nga piruneri	Të hyrat nga fletëhyrjet	Totali i të hyrave
Janar-Qershor 2020	0.00	0.00	2,791.00	2,480.00	5,253.00
Janar-Qershor 2019	0.00	200.00	4145.00	3580.00	7,925.00
Ndryshimi (2020 - 2019)	0.00	-200.00	-1354.00	-1100.00	-2,672.00

3.2 Departamenti i MLH-së

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, ky departament është marrë me mirëmbajtjen e linjave hekurudhore dhe infrastrukturës tjetër përcjellëse në mënyrë që qarkullimi i trenave dhe mjeteve tjera lëvizëse të bëhet pa problem dhe me sigurinë maksimale. Përkundër vështirësive të caktuara, realizimi i detyrave të këtij departamenti ka qenë në nivelin e kënaqshëm.

3.2.1 Kontrollimet e hekurudhës dhe objekteve përcjellëse



Gjatë periudhës janar - qershor 2020 është bërë kontrollimi i rregullt i hekurudhës dhe objekteve përcjellëse sipas planifikimit mujor dhe duke u bazuar në rregulloret ekzistuese. Kontrollimet janë kryer si kontrollime vizuale të hekurudhave dhe objekteve nëpër linjat hekurudhore duke ecur dhe duke evituar mangësitë e identifikuara në kohë sa më të

shkurtë. Një punë e madhe është bërë edhe në përcjelljen e gjendjes së binarëve, ashtu që të mos lejohet të ndodhë asnjë aksident eventual për shkak të binarëve hekurudhor. Përveç kësaj janë bërë edhe kontrollimet me matje të planifikuara të ndërrueseve dhe vendet e nevojshme në linjat hekurudhore si dhe kontrollimet nga mjetet lëvizëse të hekurudhës.

3.2.2 Rregullimi i binarit sipas kahes dhe niveletës me fuqi punëtore dhe makina plaser



Njëra nga punët kryesore gjatë mirëmbajtjes së linjave hekurudhore ka të bëjë me rregullimin e deformimeve të niveletës, kahes dhe planifikimi i kolerinës-balastit në linjat hekurudhore. Kështuqë në mënyrë që të kemi linja të sigurt për transportin e udhëtarëve dhe mallrave, gjatë këtij gjashtëmujori është bërë mirëmbajtja e rregullt e të gjitha linjave hekurudhore në funksion me makinën plaser.

3.2.3 Rregullimi i ndërrueseve sipas kahes dhe niveletës



Në këtë pozicion të punëve është bërë dhe bëhet rregullimi i deformimeve të niveletës, kahes, pjesëve të dëmtuara dhe planifikimi i koltrinės - balastit nëpër ndërruese të stacioneve hekurudhore. Kjo punë gjatë këtij gjashtëmujori të par[është kryer me mjaft sukses me dorë por edhe duke përdorur makinën e re plaser e cila e mundëson një gjë të tillë, duke e zëvendësuar punën fizike të punëtorëve.

3.2.4 Ndërrimi i traversave të vjetruara



Një punë tepër e rëndësishme e cila bëhet në vazhdimësi ndërlidhet edhe me zëvendësimin e traversave të vjetruara nëpër binarët

hekurudhor. Kjo punë është kryer me mjaft sukses edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020, me ç'rast është bërë sigurimi i qëndrueshëm i binarëve ashtu që të garantohet qarkullimi i sigurt i trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave.

3.2.5 Rregullimi dhe mirëmbajtja e binarëve



Njëra ndër punët më të rëndësishme në mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore ndërlidhet me mirëmbajtjen e rregullt dhe evitimin e mangësive nëpër binarët hekurudhor. gjatë këtij gjashtëmujorit është bërë mirëmbajtja kontinuale e binarëve sipas planeve të veprimit të përcaktuara paraprakisht dhe po ashtu sipas nevojave të përditshme duke evituar të gjitha mangësitë e përcaktuara gjatë kohës së vëzhgimit të binarëve.

3.2.6 Pastrimi i kanaleve ujë përcjellëse dhe lëshesave



Gjatë periudhës (janar – qershor) 2020 për shkak të reshjeve të shiut ka pasur shembje të dheut dhe gurëve të cilët bien edhe në kanalet ujëpërcjellëse. Mirëmbajtja e kanaleve dhe lëshesave edhe gjatë kësaj periudhe kohore gjithnjë ka qenë në nivelin e duhur duke intervenuar me kohë për pastrimin dhe rregullimin e këtyre kanaleve nëpër të gjitha linjat

hekurudhore. Kjo është me rëndësi të madhe kur dihet se për shkak të reshjeve të mëdha të shiut shpeshherë ka pasur edhe rrëshqitje të dheut.

3.2.7 Eliminimi i vendkalimeve ilegale



Duke parë se shumica e aksidenteve kanë ndodhur dhe ndodhin në vendkalimet në nivel hekurudhë – rrugë, atëherë njëra nga detyrat me prioritet të lartë gjatë këtij gjashtëmujori ka qenë e ndërlidhur me rregullimin e zonës së vendkalimeve në nivel. Kjo punë është kryer me sukses dhe të gjitha vendkalimet e rregulluara tani kanë

një nivel të kënaqshëm gjë që mundëson një lëvizje më të lehtë të automjeteve rrugore. Njëkohësisht tre muajt e fundit ka filluar edhe një aksion i cili është tepër i rëndësishëm në aspektin e sigurisë e që ndërlidhet me largimin e vendkalimeve ilegale të ndërtuara pa leje në linjat hekurudhore.

3.2.8 Kontrollimi i hekurudhës dhe objekteve përcjellëse



Një punë tepër e rëndësishme gjatë këtij gjashtëmujorit është bërë në kontrollimin e rregullt të të gjitha linjave hekurudhore dhe objekteve tjera përcjellëse. Gjatë këtyre kontrollimeve detaje teknike është bërë edhe matja e gjerësisë dhe nivelit të binarëve si dhe matja e skambjeve nëpër stacione dhe linja të hapura. Përmes këtyre kontrollimeve dhe matjeve bëhet dhe garantohet qarkullimi mi sigurt i të gjitha mjeteve lëvizëse.

3.2.9 Pastrimi i borës në skambje



Duke marrë parasysh se sezoni dimërorë gjithnjë paraqet një problem tejet të madh në zhvillimin e komunikacionit hekurudhor sepse bëhet mbulimi i skambjeve dhe binarëve nga bora dhe akulli, gjë që pengon qarkullimin e trenave nga njëri binar në tjetrin,

departamenti i linjave hekurudhore edhe këtë gjashtëmujor ka bërë një punë të shkëlqyer në pastrimin e skambjeve dhe tuneleve nga bora dhe akulli. Ky veprim i vazhdueshëm gjatë dimrit ka mundësuar qarkullimin pa pengesë të trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave.

3.2.10 Tharja e barojave në binarë



Një punë e madhe dhe e vazhdueshme gjatë këtij gjashtëmujori lidhet me pastrimin e barojave të cilat dalin nëpër linjat hekurudhore. Kështu si zakonisht në përmes spërkatjes kemi bërë dhe bëjmë eliminimin e këtyre barojave të cilat e pengojnë dhe rrezikojnë zhvillimin e komunikacionit hekurudhor.

3.2.11 Kontrollimi dhe mirëmbajtja e binarëve industrial




Gjatë këtij gjashtëmujori është bërë një punë mjaft e madhe e cila krijon të ardhura shtesë për INFRAKOS-in dhe ndërlihet edhe me mirëmbajtjen e binarëve industrial për kompanitë e ndryshme. Gjatë këtij gjashtëmujori është realizuar me sukses mirëmbajtja e binarit industrial të New Co. Ferronikeli sipas kontratës.

3.2.12 Ndërrimi i shinave me kokë të konsumuar nëpër kthesa



Njëra ndër punët më të rëndësishme të realizuara në këtë gjashtëmujor ndërlidhet me ndërrimin e shinave të cilat për shkak të peshave të rënda të trenave konsumohen, respektivisht dëmtohen, gjë që paraqet rrezik për sigurinë e qarkullimit të trenave.

3.2.13 Bartja e punëtorëve dhe materialit



Bartja e materialit nëpër vendet, respektivisht pjesët e linjave hekurudhore ku intervenohet për irëmbajtje bëhet me drezinat e kompanisë, gjë që e lehtëson shumë punën e punonjësve të MLH-së.

Gjatë këtij gjashtëmujori janë bërë shumë interevenime të tilla, qoftë për mirëmbajtje të rregullt apo qoftë për zëvendësimin e shinave dhe traversave të vjetërsuara.

3.2.14 Matja e binarëve



Gjatë muajit qershor – 2020 është bërë incizimi i binarit me vagonin matës në linjën hekurudhore Mitrovicë – Fushë Kosovë – Hani Elezit, Prishtinë - Fushë Kosovë – Pejë dhe Bardh - Medvec. Incizimi ka qenë i paraparë të bëhet gjatë muajit prill por për shkak të pandemisë nuk është bërë në atë kohë.

Pra Departamenti i MLH-së ia ka arritur me sukses që të bënë mirëmbajtjen e rregullt të infrastrukturës hekurudhore, ashtu që qarkullimi i trenave të udhëtarëve dhe atyre të mallrave të realizohet me sukses, duke garantuar kështu një siguri maksimale të qarkullimit të tyre.

3.3 Departamenti i VET

Departamenti i veprimtarisë elektroteknike gjatë gjashtëmujorit të parë ka punuar pareshtur në mirëmbajtjen e pajisjeve sinjalo siguroese, telekomunikuese dhe atyre të energjetikës. Angazhimet e këtij departamenti kanë qenë të përhershme qoftë në mirëmbajtjen e pajisjeve të veprimtarisë elektroteknike, qoftë në sanimin e menjëhershëm të pengesave të shkaktuara nga dëmtimet e këtyre pajisjeve, apo për shkak të pengesave teknike të tyre.

Ngjashëm me departamentet tjera edhe ky departament ka pasur problemet dhe sfidat e veta, mirëpo puna e planifikuar mirë dhe mbikëqyrja e realizimit të detyrave ka ndikuar që ky departament të ketë një performancë pozitive në gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

Ndër detyrat e shumta të këtij departamenti të realizuara gjatë gjashtëmujorit të parë do të përmendim ato më kryesoret:

- Është bërë kontrollimi mujor i skambjeve së bashku me departamentin e komunikacionit dhe MLH-së nëpër linjat hekurudhore në operim;
- Është bërë evitimi i pengesave në mekanizmat elektrik për vendosjen e skambjeve;
- Është bërë zëvendësimi dhe riparimi i pjesëve të dëmtuara të stabilimenteve për kontrollimin e lëvizjes së trenave;
- Është bërë rregullimi dhe riparimi i vendkalimeve automatike në nivel, sidomos pas thyerjes së gjysmë barrierave nga vozitësit e pakujdesshëm;
- Është bërë në mënyrë kontinuale riparimi i ormanëve metalik në të cilët janë të vendosura stabilimentet ss dhe kabllot e sinjalizimit;
- Është bërë intervenimi dhe riparimi i sinjaleve elektrike nëpër stacione, kurdo që për këtë ka pasur nevojë;
- Është intervenuar në mirëmbajtjen e pajisjeve të brendshme elektroteknike si dhe pajisjeve të furnizimit me tension duke bërë zëvendësimin e elementeve të prishura;
- Është bërë kontrollimi dhe intervenimi i rregullt në mirëmbajtjen e baterive stacionare për furnizim me energji të pajisjeve SS dhe TK;
- Është bërë zëvendësimi i menjëhershëm i kabllave të vjedhura SS nga palët e treta dhe riparimi i stabilimenteve përkatëse;
- Është bërë riparimi i defekteve në antenat e sistemit të radiolidhjeve;
- Është intervenuar në mënyrë kontinuale në evitimin e pengesave në sistemin e telefonisë nëpër zyra dhe stacionet hekurudhore;
- Është intervenuar në mirëmbajtjen dhe evitimin e pengesave në video sistemin e vrojtimit të stacioneve;
- Është intervenuar në eliminimin e pengesave në sistemin energjetik, përfshirë këtu, rrjetin e ndriçimit, instalimet elektrike, trafostacionet, gjeneratorë, e kështu me radhë;
- Janë bërë matjet e nevojshme të pajisjeve SS, TK dhe EN;
- Është punuar edhe në projektin e sigurimit të vendkalimeve automatike në linjën hekurudhore të Pejës; dhe

- Janë kryer edhe shumë punë dhe detyra tjera sipas nevojave dhe kërkesave ditore.

Në vijim është bërë prezantimi i disa fotografive të pajisjeve SS, TK dhe EN të cilat i mirëmban departamenti i VET-së e të cilat shërbejnë për ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës hekurudhore.



Si zakonisht edhe këtë tremujor kemi pasur sfida të konsideruara, mirëpo angazhimi i të gjithëve ka qenë në nivelin e duhur, andaj të gjitha sfidat janë tejkaluar me sukses.

3.4 Zyra e planifikim zhvillimit

Zyra për Planifikim dhe Zhvillim gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij vitit si objektiva kryesore i ka përcaktuar:

- ➔ Ngritjen e kapaciteteve njerëzore drejt rritjes së sigurisë, kualitetit dhe efektivitetit për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore.
- ➔ Ngritjen e bashkëpunimit brenda kompanisë me institucione vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të ngritjes së sigurisë dhe modernizimit të linjave hekurudhore.
- ➔ Hulimtimin e zhvillimeve, të arriturave në teknologjinë e sistemeve hekurudhore dhe propozimet e mundshme për zbatimin e tyre.
- ➔ Përpilimin e analizave financiare duke u mbështetur në kornizat buxhetore dhe projekte.

Aktivitetet kryesore dhe rezultate e arritura janë paraqitur më poshtë:

- Ofrimi i mbështetjes profesionale në realizimin e kërkesave të ndryshme në nivel të kompanisë dhe detyrave të dala nga mbledhjet e menaxhmentit.
- Angazhimi në harmonizimin e planit zhvillimor të komunës së Obiliqit m planet e Infrakos-it për planifikim hapësinor dhe zhvillim të komunës për tetë vitet e ardhshme;
- Angazhimi në menaxhim të projekteve.
- Angazhimi në harmonizimin e ligjeve aktuale mbi hekurudhat me ato të BE-së;
- Është përfunduar dokumenti informata mbi linjën e re hekurudhore Kosovë – Shqipëri
- Me programin PTV Visum është punuar modelimi i kërkesës për transport për tërë rrjetin hekurudhor të Kosovës, pra është paraqitur gjendja momentale e lëvizjes së trenave, pastaj planifikimi i trenave të udhëtarëve për secilin linje/segment hekurudhorë të prezantuar në tre skenarë, ku për secilin skenar janë bërë propozime për përmirësim të rrjetit dhe ndërtim të linjave të reja hekurudhore.
- I është ofruar mbështetje profesional Enti të Statistikave të Kosovës.
- Është duke punuar në hartimi të një koncept dokumenti të ri për linjën hekurudhore Klinë Prizren.
- Jemi duke hulumtuar zhvillimet teknologjike për të hartuar një koncepte dokumente të digjitalizimit e pronës.
- Hartimi i një koncepte dokumenti mbi gjendjen aktuale edhe evidentimin e eksponateve në “Muzeun e Hekurudhave të Kosovës” edhe mundësin e regjistrimit si muze industrial i Kosovës.
- Është duke u punuar në futjen e direktivave dhe rregulloreve të mbetura të BE-së në tabela.
- Janë duke u analizuar dokumente me pyetje rreth vendkalimeve në nivel rrugë hekurudhë, monitorimin e kushteve në të cilat gjendet infrastruktura hekurudhore si dhe sistemin e menaxhimit të aseteve të infrastrukturës hekurudhore.
- Është duke u punuar në futjen e direktivave dhe rregulloreve të mbetura të BE-së në tabela.
- Dhënia e komenteve në kërkesën e kryetarit të KK të Pejës lidhur me stacionin hekurudhor multi modal.
- Angazhim në “Hartimin e udhëzimit dhe përcaktimi i pikave për vendosjen e kamerave në objektet e INFRAKOS-it”.
- Angazhim në “Hartimi dhe standardizim kontratave të qirasë”
- Hartimi i një dokumenti për evidentimin dhe trajtimin e vendkalimeve ilegale dhe ndërhyrjet në pronën e INFRAKOS-it.

3.5 Departamenti për pronë dhe standarde

Ky departament gjatë gjashtëmuorit të parë të këtij viti ka pasur një angazhim permanent falë të të cilit ka arritur të ketë një performancë të mirë afariste. Departamenti në vete përmban: Sektorin e Patundshmërisë dhe Sektorin për Standarde.

Në vijim janë paraqitur aktivitetet e gjashtëmuorit të parë për dy sektorët përkatës të këtij departamenti.

Spektori i patundshmërisë

Gjatë gjashtëmuorit të parë të këtij viti, Spektori i patundshmërisë ka kryer me sukses detyrat duke zhvilluar vizitat në teren ku janë shpërndarë faturat për të gjithë klientët, është bërë inspektimi i pronës së INFRAKOS – it dhe shumë punë të tjera të ndërlidhura me pronën.

Spektori i patundshmërisë gjatë gjashtëmuorit të parë ka pasur një aktivitet të dendur në shumë drejtime në mënyrë që të jetë sa më afër klientëve të vet dhe të iu ofroj me kohë shërbimet e kërkuara. Aktivitetet e këtij sektori kanë qenë të shumëfishta, duke filluar nga evidentimi i saktë i pronës dhe klientëve ekzistues, ripërtëritja e kontratave dhe dhënia e kontratave të reja për klientët e ndryshëm, përgatitja dhe dorëzimi i faturave të qirasë, angazhimi për inkasimin e borxheve, ndihma për zyrën ligjore lidhur me seancat të cilat kanë të bëjnë me çështjet e pronës, takimet me të gjithë klientët e vet e deri në testimin e kënaqshmërisë së klientëve përmes pyetësorëve të ndryshëm.

Një punë të veçantë ky sektor e ka bërë në mbrojtjen e pronës së INFRAKOS-it duke u angazhuar maksimalisht që me Zyrën Ligjore të bënë paditë e duhura në gjykata për çdo cenim të pronës hekurudhore.

Për shkak të shumë problemeve me pronën në të kaluarën, Bordi i ri i Drejtorëve ka pasur një qasje shumë aktive në tre muajt e fundit për ndryshimin e politikave dhe strategjive vepruese në patundshmeri dhe duke pasur parasysh se ky sektor është me rëndësi të madhe për krijimin e të hyrave, atëherë është bërë një punë e madhe për ndryshime rrënjësore në këtë sektor.

Së pari janë mbledhur të gjitha informatat e nevojshme mbi pronën ekzistuese, gjendjen e saj dhe në veçanti është analizuar gjendja e borxheve të akumuluar me vite si dhe mënyra e mbledhjes së tyre. Spektori i pronës ka bërë një punë të palodhshme në kontaktet e rregullta me klientë duke bërë barazimin e borxheve dhe duke kërkuar pagesën e tyre nga secili klient. Ka filluar një aktivitet i madh në drejtim të mbledhjes së borxheve dhe janë hartuar listat e atyre borxhlinjve të cilëve do të u ndërpriten kontratat nëse nuk hynë në marrëveshje me INFRAKOS-in për shlyerjen e borxheve.

Një punë shumë e madhe është bërë edhe në hartimin dhe nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit me kuvendet komunale ku graviton hekurudha me

qëllim të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe çka është më e rëndësishmja edhe në harmonizimin e qëndrimeve sa i përket zhvillimit të projekteve të rëndësishme të veçantë për të dyja palët.

Departamenti i pronës ka bërë një punë të madhe duke e hartuar rregulloren e re mbi pronën e cila rregullore është ndihmuar edhe nga Bordi i Drejtorëve dhe e njëjta pas miratimit është publikuar në ueb faqen e kompanisë së bashku me kontratat e reja të hartuara konform rregullores në fjalë.

Pra rregullorja e re paraqet një transparencë të plotë në sektorin e pronës dhe krijon mundësi shumë të mëdha për menaxhim të suksesshëm me pronën. Si risi e cila do të fillon shumë shpejtë të realizohet është edhe dhënia e pronës me qira përmes shprehjeve të interesit në ueb faqen e kompanisë gjë që do të ndikon në rritjen maksimale të transparencës në këtë sektor.

Sektori për standarde

Sektori i standardeve dhe sigurisë në komunikacionin hekurudhor përveç punëve të përditshme të cilat janë të lidhura me krijimin, adoptimin dhe zbatimin e standardeve të sigurisë në të gjithë sektorët e INFRAKOS-it, punë këto të realizuara me sukses të plotë, gjatë këtij gjashtëmujori është marrë edhe me angazhimin në analizat e rregulloreve të hartuara nga ARH-ja.

Njëkohësisht ky sektor e ka përfunduar dhe dorëzuar Raportin Vjetor të Sigurisë për vitin 2019 i cili raport ka qenë gjithëpërfshirës dhe e ka trajtuar me përpikëri situatën ekzistuese të infrastrukturës hekurudhore në aspektin e sigurisë dhe plotësimit të standardeve gjatë vitit paraprak.

3.6 Departamenti i administratës

Departamenti Administratës së Përgjithshme ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar edhe gjatë këtij gjashtëmujori të parë të vitit 2020 në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij departamenti dhe kompanisë në tërësi. Në secilin sektor dhe shërbim është punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara dhe këtë ja kemi arritur me mjaft sukses.

Resurset njerëzore

Vajo që vlen të përmendet për resurset Njerëzore në këtë gjashtëmujor është publikimi i konkursit me datën 6/01/2020 për pranimin e punëtorëve të rinj ër pozitat:

- Ndërrues të binarëve – praktikant (9 pozita);
- Drejtues të lëvizjes së trenave – praktikant (6 pozita);
- Zyrtar ligjor (1 pozitë);
- Ekonomist i diplomuar praktikant (1 pozitë);

Pas përfundimit të procedurave të konkursit komisionet e përzgjedhjes kanë pranuar në punë si punëtorë të rinj nga jashtë njëzet (20) punëtorë në pozitat Drejtues treni dhe Ndërrues të binarëve dhe dy (2) punëtorë në shërbimet administrative. Procedurave të konkursit publik iu kanë bashkëngjitur edhe punëtor të brendshëm (aktiv) të Infracos prej cilëve pesë janë përzgjedhur (katër për pozitën drejtues treni dhe një për pozitën ndërrues i binarëve). Numri i të rekrutuarve është rritur mbi konkursin.

E tërë procedura e përzgjedhjes së punëtorëve ka pasur shkelje të mëdha për ç'arësye Bordi i Drejtorëve ka marrë vendim, ndërsa me datën 18/06/2020 UD i KE ka marrë vendim që të anulohet konkursi i datës 16/01/2020 dhe me këtë rast janë zhvleftësuar vendimet mbi pranimin e të gjithë punëtorëve nga konkursi në fjalë.

Shërbimi i logjistikës

Shërbimi i logjistikës ka zhvilluar një aktivitet të konsideruar gjatë këtij gjashtë mujori në përpjekje për të përmbushur objektivat e këtij shërbimi. Secila njësi dhe komplet shërbimi ka punuar në vazhdimësi për arritjen e objektivave të planifikuara, me gjithë vështirësitë me të cilat jemi duke u përballur për shkak të gjendjes jo të mirë dhe vjetërsisë së veturave me të cilat posedojmë. Edhe për kundër kësaj mirëmbajtja e veturave gjatë kësaj periudhe ka përmbushur me sukses objektivat e saja:

- Është bërë servisimi i rregullt i të gjitha veturave;
- Është bërë regjistrimi dhe sigurimi në afatet e parapara ligjore i të gjitha veturave;
- Është bërë kompletimi me të gjitha pajisjet përcjellëse;
- Është bërë pastrimi dhe furnizimi i rregullt me naftë;
- Është bërë përcjellja e fletudhëtimeve dhe kilometrave të kaluara për çdo veturë veç e veç dhe për të gjitha së bashku.

Pastrimi

Edhe pastrimi në përgjithësi ka arritur objektivat e veta ku me sukses kemi arritur që të bëjmë pastrimin e të gjitha hapësirave të objekteve, zyrave, hapësirës përreth objektit të stacionit dhe peronave. Në dy muajt e parë të vitit kemi bërë edhe pastrimin e borës dhe të akullit në vendet më të frekuentuara me pasagjerë dhe qytetarë tjerë. Përveç pastrimit ditor kemi bërë edhe pastrime gjenerale si në oborrin e stacionit hekurudhor ashtu edhe në objekte tjera të INFRAKOS-it

Shërbimi i mirëmbajtjes së objekteve

Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti shërbimi i mirëmbajtjes së objekteve i ka kryer me sukses të gjitha detyrat e parapara dhe atyre të përditshme duke:

- Mirëmbajtur dhe eliminuar me kohë të gjitha pengesat eventuale të sisatemit të ngrohjes qendrore gjatë sezonit të dimrit;
- Mirëmbajtur dhe eliminuar të gjitha mangësitë në sistemin e ujës-jellësit në tërë rrjetin hekurudhor;
- Mirëmbajtur dhe eliminuar të gjitha mangësitë në sistemin e kanalizimit në tërë rrjetin hekurudhor;
- Mirëmbajtur dhe eliminuar të gjitha mangësitë në të gjitha ndërtesat e stacioneve në tërë rrjetin hekurudhor;
- Mirëmbajtur dhe eliminuar të gjitha mangësitë në të gjitha ndërtesat e stacionit qendror në Fushë Kosovë; dhe
- Mirëmbajtur dhe eliminuar të gjitha mangësitë në të gjitha zyrat dhe objektet përcjellëse në ndërtesat e INFRAKOS-it.

Shërbimi i shkrimores dhe arkivit

Shërbimi i shkrimores dhe arkivit gjatë këtij gjashtëmujori ka kryer me sukses detyrat e parapara të paraqitura në vijim:

- Dërgesa me postë gjithsejtë janë = 1025;
- Kërkesa hyrëse = 93
- Lëndët nga gjykata = 137
- Fatura hyrëse = 329
- Lëndët e punuara brenda dhe shpërndara jashtë = 90
- Lëndët punuara brenda dhe shpërndara brenda = 130
- Dërgesa me postë = 75
- Kontrata pune = 13
- Aplikacione = 158

Si tërësi, punët dhe detyrat e planifikuara për këtë periudhë kohore kanë shkuar mirë. Pengesë në realizimin e projekteve më të mëdha edhe më tutje është mungesa e buxhetit.

3.7 Departamenti për MMP, SHMP dhe TI

Departamenti i Marrëdhënies me Publikun, Shkollim Mbrojtje në Punë dhe Teknologji Informative gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti i ka kryer me sukses detyrat e planifikuara. Në kuadër të këtij Departamenti janë këta sektorë:

- Sektori për Marrëdhënie me Publikun dhe përkthime;
- Sektori për Shkollim, Siguri dhe Mbrojtje në Punë;
- Sektori për Teknologji Informative; dhe
- Zyra për Marketing.

Që të gjithë sektorët e sipërpërmendur kanë pasur angazhim maksimal gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti duke i realizuar me sukses të gjitha detyrat e

parapara me planin e biznesit, respektivisht me planin e veprimit të këtij departamenti të INFRAKOS-it.

Zyra për marrëdhënie me publikun dhe marketing

Zyra për Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing vazhdimisht e ka përcjell dhe e ka zbatuar Planin e Biznesit në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të aplikuara në kompani.

Përveç komunikimeve të rregullt me të gjitha mediat dhe institucionet përkatëse të rëndësishme të veçantë për sektorin hekurudhor, kjo zyrë ka bërë edhe monitorimin e mediave për të gjitha rastet të cilat ndërlidhen me hekurudhat.

Marrë në tërësi zyra për marrëdhënie me publikun dhe marketing në vazhdimësi ka realizuar detyrat e përcaktuara me planin e biznesit, respektivisht planin e veprimit të kompanisë.

Spektori për shkollim, siguri dhe mbrojtje në punë

Në këtë periudhë kohore menaxhimi i rregullt i sektorit për shkollim, siguri dhe mbrojtje në punë ka qenë në nivelin e dëshirueshëm në realizimin e detyrave të përcaktuara me planin e biznesit.

Më poshtë janë prezantuar disa nga aktivitetet e proceduara gjatë kësaj periudhe nga ky sektor:

- Shkollimi (ligjëratat) për drejtuesit e trenave;
- Shkollimi për ndërrues, krye ndërrues të binarëve;
- Shkollim (ligjëratat) për shefat e njësisë;
- Shkollimi (ligjëratat) për Kryepunëtor;
- Shkollimi (ligjëratat) për Vozitës të Drezinave të lehta;
- Shkollimi (ligjëratat) për rojtarët e linjave hekurudhore

Spektori i teknologjisë informative

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të këtij viti ky sektor i ka realizuar këto punë dhe detyra:

- Mirëmbajtje e rregullte efektive e pajisjeve dhe rrjetës së Teknologjisë Informative
- Ngritja e nivelit të sigurisë së sistemit të Teknologjisë Informative
- Janë montuar, instaluar dhe konfiguruar pajisje kompjuterike sipas nevojës dhe kërkesave të zyrtarëve të Infracos-it.
- WSUS Serverit përkatësisht konzollës për update ia kemi larguar (fshire) filet e vjetër dhe të pa nevojshëm për instalim.

- Kemi intervenuar në WSUS Server pas problemeve që janë paraqitur me marrje të updateve nga Serverët dhe kompjuterët.
- UPS 3000VA në rackun e serverëve ia kemi ndërruar bateritë dhe gjithashtu i kemi testuar.
- Kemi arritur që ti ri funksionalizime 3 server fizik dhe 7 virtual për ri-startimit në mënyrë të dhunshme me datën 24.01.2020
- Kemi qenë në gjendje gatishmërie në sistemin dhe rrjetën e kompjuterike për shkak të ndërprerjeve të rrymës elektrike dhe të mos funksionimit (ndaljes) se gjeneratorit herë pas here për ftohje të tij sidomos gjatë muajit Mars.
- Është ri-funksionalizuar antena wireless për internet në ndërtesën e Elektros për shkak të dëmtimit nga era e fuqishme.
- Është ri instaluar Fire Power e ASA Firewallit Fizik
- Është bere rebulit (ringritur) në funksion HDD (hardisku) i katërt në serverin e HYPER-V2

3.8 Departamenti i prokurimit

Departamenti i prokurimit i ka kryer me sukses detyrat e parashtruara me Planin e Veprimit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, duke bërë me kujdesin më të madh realizimin e projekteve kapitale të kompanisë dhe furnizimeve tjera gjithnjë duke ju përmbajtur legjislacionit dhe rregulloreve ekzistuese në fuqi.

Projektet kapitale

Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti departamenti i prokurimit në bashkëpunim të plotë me departamentet përkatëse pas kërkesës së Njesisë për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike për ndërprerjen e procedurave për tenderimin e projekteve kapitale për shkak të nevojave buxhetore për luftimin e pandemisë me COVID 19, ka marrë vendim që të mos procedohet me projekte kapitale.

Kështu që mjetet e mbetura nga projektet kapitale do të tentohet ë të transferohen në subvencionim të diferencës ndërmjet kostos direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe të hyrave nga pagesat e qasjes në binarë.

Projektet e financuara nga buxheti i kompanisë

Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti departamenti i prokurimit në bashkëpunim të plotë me departamentet përkatëse i ka zbatuar me sukses kërkesat e njësive kërkuese për realizimin e një numri të projekteve nga buxheti i kompanisë duke filluar nga furnizimi me material dhe pjesë rezervë e deri tek pagesa e shërbimeve të ofruara nga kompanitë e ndryshme për nevojat e INFRAKOS-it.

Në gjashtëmujorin e parë janë realizuar me sukses të plotë më se 27 projekte me një buxhet të parashikuar prej 34,260.00 €, ndërsa të realizuar në vlerën prej 33,598.03 €.

Përmbushja e detyrave e departamentit të prokurimit në këtë gjashtëmujor ka qenë e plotë dhe ky departament do të vazhdojë edhe më tej realizimin e detyrave të përcaktuara me planin e prokurimit.

3.9 Kontrolli i brendshëm

Realizimi dhe përfundimi i punëve të planifikuara dhe detyrave të parapara me planin e veprimit ka qenë njëri ndër prioritetet kryesore të kontrollorit të brendshëm për muajt Janar – Qershor të këtij viti. Kjo është bërë me të vetmin qëllim që cilësia e shërbimeve të ofruara dhe siguria e infrastrukturës hekurudhore të jetë në nivelin më të lartë të mundshëm. Në vijim janë paraqitur punët kryesore të realizuara gjatë këtij gjashtëmujori:

- Kontrolli i rregullt në stacione;
- Kontrolli i rregullt në vijat hekurudhore;
- Kontrolli i rregullt i stafit ekzekutiv;
- Kontrolli i rregullt i natës;
- Përcjellja e trenave të udhëtarëve;
- Kontrolli detaj i pajisjeve të sinjalizimit - sigurimit, shenjave treguese dhe kanaleve anësore për kullimin e ujit nga të reshurat atmosferike;
- Realizimi edhe i shumë punëve dhe detyrave tjera sipas nevojave ditore.

Puna e kontrollorit të brendshëm gjatë këtij gjashtëmujori ka qenë shumë aktive dhe e frytshme duke përcjellur kështu informacionet e nevojshme lidhur me gjendjen ekzistuese në terren dhe punën e të gjithë stafit ekzekutiv, gjë që ka ndihmuar shumë kompaninë në evitimin e mangësive eventuale dhe ngritjen e efikasitetit në punë.

Për gjendjen ekzistuese pas secilit kontrollim janë hartuar raportet përkatëse duke i njoftuar me shkrim personat përgjegjës të sektorëve të caktuar dhe duke kërkuar evitimin e mangësive të gjetura gjatë kontrollimit.

4. Performanca financiare e INFRAKOS-it

Gjashtëmujori i parë i vitit 2020 ka qenë shumë sfidues për funksionimin e Infrastrukturës së Hekurudhave të Kosovës ShA, duke marrë parasysh situatën e rëndë financiare nga viti paraprak, situatë kjo e cila është vështirësuar edhe më shumë për shkak të pandemisë me COVID 19 dhe se përkundër kërkesave tona të arsyeshme ne nuk përfituam asgjë nga pakoja e katërt fiskale e Ministrisë së financave dhe Transfereve. Për më keq përkundër kërkesave kontinuale ne akoma nuk e kemi të garantuar subvencionin e kërkuar dhe as nuk është nënshkruar marrëveshja financiare pesëvjeçare për financimin e INFRAKOS-it.

Në drejtim të sqarimit më të mirë të gjendjes ekzistuese financiare të kompanisë për gjashtëmujorin e parë të këtij viti, në tabelën vijuese është bërë prezantimi i të hyrave dhe shpenzimeve për këtë periudhë kohore.

Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve për (janar-qershor) 2020		Realizimi 2019	Realizimi 2020	Buxheti 2020	Diferenca	Diferenca
		A	B	C	B - A	B - C
TË HYRAT	Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit	248,389.06	181,149.46	249,000.00	-67,239.60	-67,850.54
	Të hyrat nga qiraja	320,421.61	343,089.13	365,000.00	22,667.52	-21,910.87
	Të hyrat tjera	110,372.35	172,154.12	123,000.00	61,781.77	49,154.12
	Subvencionimi i diferencës së rrjetit	549,978.87	282,249.25	600,000.00	-267,729.62	-317,750.75
	Të hyrat e shtyra	511,145.92	509,565.19	471,000.00	-1,580.73	38,565.19
	Të hyrat totale	1,740,307.81	1,488,207.15	1,808,000.00	-252,100.66	-319,792.85
SHPENZIMET	Pajisjet	2,640.45	12,237.42	38,500.00	9,596.97	-26,262.58
	Harxh. e lokal. ndërtesave	13,435.23	11,843.26	57,200.00	-1,591.97	-45,356.74
	Energjia elektrike	58,545.20	56,361.99	100,000.00	-2,183.21	-43,638.01
	Nafta	19,739.41	8,189.31	29,500.00	-11,550.10	-21,310.69
	Vajrat, lysterës, etj.	0	0	4,000.00	0.00	-4,000.00
	Materiali harxhues operativ	13,150.11	10,487.17	17,200.00	-2,662.94	-6,712.83
	Riparimet	5,882.71	2,257.63	35,075.00	-3,625.08	-32,817.37
	Shërbimet operative	1,019.61	8,775.74	730	7,756.13	8,045.74
	Udhëtimet zyrtare	790	362.64	22,235.00	-427.36	-21,872.36
	Marketingu dhe publikimet	4,592.13	3,161.55	840	-1,430.58	2,321.55
	Mat. i zyrës dhe konsumues	4,689.87	3,905.69	19,900.00	-784.18	-15,994.31

Telefoni / mail / interneti	7,157.08	5,448.25	15,744.00	-1,708.83	-10,295.75
Shpenz. e rrezikshmërisë	63,741.67	3,038.00	45,000.00	-60,703.67	-41,962.00
Reprezetntac./ konsumueset	3,184.28	720.93	15,424.10	-2,463.35	-14,703.17
Sigurimi	8,588.69	7,904.93	30,030.00	-683.76	-22,125.07
Stafi i jashtëm	170	984	6,300.00	814.00	-5,316.00
Stafi dhe punëtorët	1,048,584.82	1,012,881.92	1,149,000.00	-35,702.90	-136,118.08
Shpenzimet tjera operative	8,065.95	3,010.00	86,950.00	-5,055.95	-83,940.00
Shpenzimet totale	1,263,977.21	1,151,570.43	1,673,628.10	-112,406.78	-522,057.67
Diferenca (të hyrat – shpenzimet)	476,330.60	336,636.72	134,371.90	-139,693.88	202,264.82
Amortizimi	598,905.80	603,338.49	611,000.00	4,432.69	-7,661.51
Art. Financiar	338.93	284.15	4,500.00	-54.78	-4,215.85
Shpenzimet e jashtëzakonshme	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Taksat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Rezultati operativ	-122,914.13	-266,985.92	-481,128.10	-144,071.79	214,142.18

Të hyrat

Sa i përket të hyrave për periudhën (janar – qershor) 2020 e të cilat janë prezantuar në tabelën e mësipërme mund të konstatojmë sa vijon:

Të hyrat nga shfrytëzimi i rrjetit - Në gjashtëmuorin e parë janë realizuar 181,149.46 € apo 67,850.54 € më pak sesa shuma e buxhetit të planifikuar prej 249,000.00 €, respektivisht 67,239.60 € më pakë sesa shuma e realizuar në vitin 2019. Vlen të përmendet se këtë gjashtëmuor nuk janë realizuar të hyrat e planifikuara nga qasja në rrjet pasi që për shkak të pandemisë TRAINKOS-i ka ndërprerë për një kohë qarkullimin e trenave të udhëtarëve për shkak të pandemisë me COVID 19.


Të hyrat nga qiraja - Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 343,089.13 € e që krahasuar me buxhetin 365,000.00 €, del se ne kemi realizuar 21,910.87 € më pakë të hyra se sa ka qenë e planifikuar për këtë periudhë, ndërsa krahasuar me vitin 2019 ku kishim realizuar 320,421.61 €, del se kemi realizuar 22,667.52 € më shumë.

Të hyrat tjera - Për këtë periudhë janë realizuar 172,154.12 €, ndërsa të planifikuara kanë qenë 123,000.00 €. Pra kemi realizim prej 49,154.12 € më të madh nga planifikimi për këtë periudhë kohore. Krahasuar me vitin 2019 ku kishim realizuar 110,372.35 €, del se kemi realizuar 61,781.77 € më shumë.

Subvencionimi - Për këtë periudhë kohore ka qenë i paraparë subvencionimi në vlerë prej 600,000.00 €, ndërsa kur të llogaritet TVSH-ja mbetet se janë realizuar 549,978.87 € në emër të subvencionimit të diferencës së pagesave të qasjes në rrjet nga Qeveria. Për fat të keq përkundër kërkesave tona të vazhdueshme për subvencionimin shtesë të paraparë me Ligj dhe të llogaritur sipas kostos direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës, institucionet përgjegjëse deri më sot nuk kanë bërë asnjë lëvizje pozitive në këtë drejtim. Kjo e ka sjellë INFRAKOS-in në një situatë tejet të vështirë financiare dhe në qoftë se nuk bëhet subvencionimi shtesë, kompania nuk ka gjasa që të mund të operojë më tutje.

Të hyrat e shtyra - Për këtë periudhë në emër të të hyrave shtesë janë evidentuar 509,565.19 €, ndërsa të planifikuara kanë qenë 471,000.00 €. Kjo e dhënë lidhet me llogaritjen e amortizimit të mjeteve ekzistuese të kompanisë.

Në diagramin vijues është bërë paraqitja grafike e të hyrave të buxhetuara dhe atyre të realizuara për këtë periudhë kohore, duke i krahasuar ato me të hyrat e realizuara në vitin 2019.



Shpenzimet

Një kujdes i veçantë në gjashtëmuorin e parë të këtij viti i është kushtuar shpenzimeve, duke reduktuar maksimalisht ato, ashtu që të ruhet rentabiliteti i kompanisë. Sa i përket shpenzimeve për këtë gjashtëmuor e të cilat janë prezantuar në tabelën e mësipërme mund të konstatojmë sa vijon:

Shpenzimet e planifikuara dhe realizuara - Sa i përket shpenzimeve mund të konstatojmë se shpenzimet e realizuara në këtë gjashtëmuor janë

1,151,570.43 € që në krahasim me shpenzimet e planifikuara 1,673,628.10 €, janë për 522,057.67 € më të vogla, respektivisht krahasuar me shpenzimet e vitit paraprak 1,263,977.21 €, janë për 112,406.78 € më të vogla. Kjo tregon se duke e ditur situatën tonë të vështirë financiare, ne kemi pasur një angazhim maksimal që të zvogëlojmë shpenzimet e kompanisë.


Nga tabela e mësipërme shihet se me përjashtim të shpenzimeve operative të cilat janë për 8,045.74 € më të mëdha dhe shpenzimet për marketing dhe publikime për 2,321.55 € më të mëdha; të gjitha shpenzimet tjera gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti janë më të vogla në krahasim me ato të buxhetuara.

Krahasimi i të hyrave dhe shpenzimeve

Bazuar në tabelën e mësipërme dhe duke i krahasuar të hyrat me shpenzimet, del se në këtë gjashtëmujor INFRAKOS-i ka pasur një kujdes të madh me menaxhimin e financave të kompanisë, gjë që si rrjedhojë në gjashtëmujorin e parë të këtij viti kemi arritur ta ruajmë sigurinë financiare për një operim elementar të kompanisë.

Të hyrat totale në këtë gjashtëmujor janë 1,488,207.15 € duke llogaritur të hyrat e shtyra, ndërsa shpenzimet totale janë 2,091,829.79 € po ashtu duke llogaritur amortizimin. Prandaj, diferenca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve ka një bilanc negativ në vlerën prej 266,985.92 €.

Por në qoftë se llogaritet kjo diferencë ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve pa i llogaritur të hyrat e shtyra dhe amortizimin, atëherë diferenca ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve është minus 172,928.47 €. Mirëpo, ne e dimë se ky rezultat ka ardhur si pasojë e mos realizimit të paraparë të transportit hekurudhor nga operatorët e transportit, si dhe mos subvencionimit të plotë të diferencës ndërmjet kostos direkte dhe të hyrave nga pagesat e qasjes në rrjet. Sikur kjo të realizohej, atëherë kompania do të kishte një bilanc pozitiv.



5. *Procedurat gjyqësore*

Angazhimi i përhershëm dhe profesional i zyrës ligjore edhe në këtë gjashtëmuor ka bërë që INFRAKOS-i të mbrojë me shumë sukses interesin e kompanisë, qoftë në rastet kur kemi qenë të paditur, apo qoftë në rastet kur kemi qenë si paditës. Pra, zyra ligjore e INFRAKOS-it në gjashtëmuorin e parë të këtij viti ka pasur një performancë pozitive dhe të kënaqshme.

5.1 *Procedurat gjyqësore në gjashtëmuorin e parë të vitit 2020*

Zyra Ligjore e INFRAKOS-it gjatë punës gjashtëmuore Janar-Qershor 2020 ka zhvilluar një punë të pandërprerë dhe profesionale në përfaqësimin e kompanisë me qëllim të mbrojtjes së pronës, infrastrukturës hekurudhore dhe interesit të kompanisë nga uzurpatorët dhe dëmtuesit, qoftë nga personat fizik dhe juridik duke përfshi edhe komunat në të cilat shtrihet infrastruktura hekurudhore.

Sipas të dhënave paraprake në fillim të vitit në Zyrën Ligjore kishim 439 lëndë në procedura ligjore dhe 174 lëndë në procedurë përmbaremore në total prej 613 lëndëve. Në vijim të punës kemi analizuar disa lëndë duke përfshi edhe vendimet që kanë arritur në gjashtëmuorin e parë dhe është konstatuar se për 12 raste penale Gjykatat themelore në Prizren i ka shpallur fajtor personat ndaj të cilëve kemi ushtruar kallëzime penale për uzurpim prone, ndërsa për 9 raste kemi hedhje të kallëzimeve penale nga prokuroria dhe hedhje të aktakuzave nga Gjykata. Gjatë kësaj periudhe kanë arritur 7 vendime në favor të kompanisë dhe tre në disfavor të kompanisë. Dy nga këto vendime kanë pasur të bëjnë me kompensime të kontributeve pensionale dhe pagave jubilarë, ndërsa vendimi tjetër ka pasur të bëjë me obligimet tatimore ndaj komunës së Prishtinës. Praktikiisht te tri këto raste nuk është dashur fare të lejohet të shkojnë në Gjykatë pasi që nuk kemi pasur asnjë bazë për kundërshtim të tyre.

Bazuar në këtë, aktualisht kemi një zvogëlim të numrit të rasteve për 23 lëndë, ndërsa kemi vetëm 1 (një) lëndë të re. Si rrjedhojë aktualisht kemi 416 lëndë aktive në Gjykata ndërsa numri i lëndëve në procedurë përmbaremore ka mbetur i njëjtë. Gjatë kësaj periudhe stafi i Zyrës Ligjore ka hartuar një numër të madh të shkresave të ndryshme juridike, ka marr pjesë në 87 seanca gjyqësore dhe ka kontaktuar në vazhdimësi të gjithë përmbareuesit privat të angazhuar më lëndët e Infracos.

Megjithëse gjatë kësaj periudhe kemi qenë në një fazë tranzitore të ndërrimit të udhëheqjes së zyrës, bartjes së përgjegjësisë, puna e saj është karakterizuar me një përkushtim dhe angazhim profesional, gjithnjë duke u bazuar në autorizimet, detyrat dhe obligimet që rrjedhin nga aktet e brendshme të ndërmarrjes si dhe zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi. Sfidë mbetet numri i madh i lëndëve dhe mundësia që të rritet ky numër, për shkak të borxheve të mëhershme nga qiratë, mosnjohjes së dispozitave ligjore hekurudhore për distancat si dhe nga vet shtrirja e pronës në tërë territorin e vendit apo relacione

tjera administrative dhe jo vetëm. Për shkak të numrit të madh të lëndëve do të analizohet mundësia e ristrukturimit të zyrës ligjore si për nga kapacitetet profesionale, për nga numri ashtu edhe për nga cilësia.

Vlen të ceket se gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2020 për shkak të COVID19 ka pasur numër të kufizuar pasi që me pas është pezulluar aktiviteti i rregullt i Gjykatave. Gjykatat gjatë kësaj periudhe punojnë vetëm në raste urgjente por kjo nënkupton se në periudhën në vijim sikurse ishte muaji korrik do të kemi numër shume më të madh të seancave.

5.2 Procedurat gjyqësore që pritet të realizohen në gjashtëmujorin e dytë

Bazuar në prezantimin e mësipërm shihet se Zyra Ligjore e INFRAKOS-it gjatë gjashtë muajit të parë të vitit 2020 ka pasur shumë konteste gjyqësore të cilat janë mbajtur në këtë periudhë kohore. Përkundër disa vendimeve përfundimtare një numër i këtyre kontesteve do të vazhdon të zhvillohet në gjashtëmujorin e dytë të këtij viti, ndërsa Zyra Ligjore është e gatshme që të bënë edhe padi të reja sipas nevojës, apo të përgatis mbrojtjen e rasteve të reja nëse ndokush do ta padis INFRAKOS-in.

Sidoqoftë, vlen të përmendet se angazhimi i zyrës ligjore të INFRAKOS-it ka qenë dhe do të jetë shumë i madh edhe në gjashtëmujorin vijues, duke e mbrojtur në maksimum interesat e kompanisë. Gjashtëmujori paraparak tregon për një performancë të mirë të kësaj zyreje, kështuqë ne presim të njëjtën performancë edhe në pjesën e dytë të vitit 2020.

6. Transaksionet në gjashtëmuja të parë

INFRAKOS-i sikurse edhe në vitet paraprake, edhe në këtë gjashtëmuja ka bërë të gjitha pagesat e nevojshme qoftë për furnizime, qoftë për projekte kapitale, apo çfarëdo lloj pagese tjetër duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Të gjitha pagesat në këtë gjashtëmuja janë bërë përmes transaksioneve bankare duke zbatuar procedurat financiare. Njëherazi vlen të përmendet se në këtë gjashtëmuja nuk ka pasur ndonjë transaksion të madh të mjeteve i cili do të vlente të përmendet. Mirëpo, financat tona edhe në gjashtëmuja vijues do të zbatohen në tërësi ligjet e Kosovës mbi menaxhimin e financave publike.

7. *Sugjerimet për ngritjen e performancës*

Gjashtëmujori i parë i vitit 2020 ka qenë një periudhë kohore me sfida të mëdha për INFRAKOS-in. Vazhdimi i gjendjes ekzistuese nga viti paraprak kur Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk ka bërë mbulimin e plotë të diferencës së kostos direkte ka vazhduar edhe këtë gjashtëmujor, gjë që për INFRAKOS-in paraqet një problem shumë të madh. Mirëpo, duke ditur se situata financiare mbetet tejet kritike, kjo ka ndikuar që të bëjmë një menaxhim shumë të kujdesshëm të shpenzimeve të kompanisë.

INFRAKOS-i gjatë gjashtëmujorit të parë ka bërë analiza të hollësishme rreth situatës aktuale duke kërkuar nga institucionet përgjegjëse që në gjashtëmujorin vijues të ndërmarrin hapat e duhur për dalje nga situata ekzistuese dhe në të mirë të zhvillimit dhe operimit pa problem të kompanisë. Kërkesat tona për një mbështetje të nevojshme dhe emergjente nga shteti për subvencionimin e kompanisë në gjashtëmujorin e dytë janë të përhershme, andaj ne shpresojmë se kjo do të ndodhë, sepse në të kundërtën kjo kompani nuk do të mund të funksionojë.

Bazuar në analizat tona të mirëfillta, ne kemi disa sugjerime të cilat do të ndikojnë në ecjen pozitive të kompanisë, por edhe të sektorit hekurudhor në tërësi:

- Subvencionimi urgjent i INFRAKOS-it për mbulimin e diferencës në mes të kostos direkte të mirëmbajtjes së infrastrukturës dhe pagesave të qasjes në rrjet për pjesën e dytë të vitit 2020;
- Nënshkrimi i marrëveshjes financiare pesëvjeçare ndërmjet Qeverisë dhe INFRAKOS-it e paraparë me Ligjin mbi Hekurudhat Nr. 04/L-063;

Subvencionimi i INFRAKOS-it

Sa i përket subvencionimit do të përmendim se bazuar në Nënkreun e katërt të Ligjit mbi Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-063, Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS ka bërë me kohë përpilimin e Ekspozeut të Rrjetit për vitin 2020. Ky ekspozitë ishte punuar tërësisht sipas Ligjit mbi Hekurudhat, parimeve të Rrjetit Hekurudhor Evropian dhe sa i përket kostove direkte të infrastrukturës duke u bazuar tërësisht në Udhëzimin Administrativ nr. 02/2014 të datës 28.06.2014 të nxjerrë nga Ministria e Infrastrukturës.

Për fat të keq, përkundër sqarimeve të detajuara nga ana e jonë për të gjitha palët e interesit, Ekspozeu i Rrjetit për vitin 2020 i propozuar nga INFRAKOS-i nuk u miratua nga MI-ja. Ministria e Infrastrukturës duke zbatuar të drejtën e saj ligjore, me Vendimin e Ministrit të Infrastrukturës edhe për këtë vit ka bërë miratimin e Ekspozeut të Rrjetit të njëjtë me atë të vitin 2020, ku pagesat e qasjes në rrjet janë të zvogëluara në mënyrë drastike dhe shumica e shërbimeve tjera pa pagesë.

Ne presim që subvencionimi i kërkuar të realizohet në pjesën e dytë të vitit në mënyrë që të sigurohet funksionimi i kompanisë dhe të garantohet siguria e qarkullimit të trenave nëpër linjat hekurudhore.

Marrëveshja financiare pesëvjeçare

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës ShA – INFRAKOS, duke u bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës nr. 04/L-63 të miratuar me datën 14.11.2011, respektivisht Nenin 63 - Paragrafin 3; Nenin 14, Nenin 15 - Paragrafin 2, Nenin 118 - Paragrafin 5 dhe Nenin 123 - Paragrafin 3, 4, 5, 6 dhe 7; me qëllim të përkrahjes financiare për funksionim të infrastrukturës hekurudhore duhet që të nënshkruajnë marrëveshje financiare pesëvjeçare përmes së cilës rregullohet mënyra e financimit dhe vlera e financimit e INFRAKOS-it.

Për fat të keq përkundër kërkesave tona të shumta të ripërsëritura edhe këtë gjashtëmuor, kjo marrëveshje akoma nuk është nënshkruar edhe pse dihet se me nënshkrimin e saj njëherë e përgjithmonë do të rregullohej gjendja financiare e INFRAKOS-it.

UD i Kryeshefit Ekzekutiv

Xhevat Ramosaj